



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**RAPORT I MONITORIMIT NË LIDHJE ME BLERJET E ENERGJISË ELEKTRIKE**  
**PAGESAT DHE NOMIMIMET PËR OPERATORIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT**  
**(KOSTT)**

**Nëntor, 2022**

## Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
Hyrje.....	3
Qëllimi i Monitorimit.....	3
Informacion i përgjithshëm i ndërmarrjes së monitoruara .....	3
Faturimi dhe Pagesat ndërmjet të Licencuarve .....	4
Blerjet e energjisë nga KOSTT për mbulim të humbjeve në rrjetin e transmetimit .....	7
Blerjet e energjisë nga KOSTT për mbulim të humbjeve në veri të vendit.....	11
Devijimet e sistemit në raport me rrjetin interkonektiv.....	13
Shfrytëzimi i Fondit për energjinë e ripërtrishme (FER) .....	17

## Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), në përputhje me Nenin 54 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084), ushtron mbikëqyrje për pajtueshmërinë me kushtet e Licencës, zbatimin e ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Ligjit për Energjinë Elektrike, Ligjit për Energjinë, zbatimin e akteve, vendimeve dhe udhëzimeve të lëshuara nga ZRRE-ja.

Mbështetur në dispozitat ligjore në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, në zbatim të Monitorimit të Tregut është kryer monitorimi mbi pajtueshmërinë me kushtet e licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit (në tekstin në vijim KOSTT), si dhe kushteve tjera që kanë të bëjnë me blerjet dhe shitjet e energjisë elektrike dhe devijimit e energjisë.

## Qëllimi i Monitorimit

Qëllimi i Monitorimit është dhënia e opinionit të pajtueshmërisë nëse në të gjithë aspektet materiale, aktivitetet ekonomike dhe financiare, transaksionet dhe informacionet janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe kornizën rregullative në fuqi.

Qëllimi i këtij monitorimi është fokusuar në evidentimin e devijimeve nga parimet e ligjshmërisë, si:

- Faturimi dhe Pagesat ndërmjet të Licencuarve;
- Blerjet e energjisë nga KOSTT për mbulim të humbjeve në rrjetin e transmetimit,
- Blerjet e energjisë nga KOSTT për mbulim të humbjeve në katër komunat veriore të Kosovës,
- Devijimet e sistemit në raport me rrjetin interkonektiv përfshirë rezervat rregulluese.
  - Shfrytëzimi i rezervave rregulluese
- Shfrytëzimi i Fondit për energjinë e ripërtrishme (FER)

## Informacion i përgjithshëm i ndërmarrjes së monitoruara

Operatori Sistemi, Transmisioni dhe Tregu SHA (KOSTT) është themeluar si shoqëri aksionare, në bazë të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, sipas kërkesave të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 03 / L-201 dhe Udhëzuesit për Shturje të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë ("ZRRE") dhe operon me dy licenca, Licenca për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike dhe Licenca për Operatorin e Tregut të Energjisë Elektrike.

KOSTT menaxhon Sistemin e Transmetimit të Republikës së Kosovës duke operuar me nivele të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV dhe është përgjegjës për funksionimin, sigurimin e mirëmbajtjes, dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit në zona të caktuara, si dhe është përgjegjës për ndërlihdjen e rrjetit me rrjetet e tjera. Poashtu, KOSTT operon edhe si Operator i Tregut dhe është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregtimit (shit-blerjes) të energjisë elektrike dhe përcaktimin e pagesave në mes të prodhuesve, furnizuesve, dhe klientëve.

KOSTT është 100% në pronësi të Kuvendit të Kosovës dhe aktiviteti i tij rregullohet me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, legjislacionin sekondar dhe operon në bazë të licencave të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji, e cila është përgjegjëse për monitorim/mbikëqyrje të zbatimit të kushteve ligjore të licencës.

Ndër detyrat kryesore të aktivitetit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit është transmetimi i energjisë elektrike; mes tjerash edhe:

- a) Operimi, mirëmbaj dhe zhvillon sistemin e transmetimit;
- b) Balancimi i sistemit elektroenergjetik të Kosovës si dhe alokimi i kapaciteteve interkonektive me sistemet tjera;
- c) Pajtushmëria me dispozitat e Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes dhe Kodit të Shpërndarjes
- a) Sigurimi i qasjes jodiskriminuese për shfrytëzuesit e rrjetit të transmetimit
- b) Aplikimi i tarifave dhe taksave për shfrytëzim dhe kyçje në rrjetin e transmetimit
- c) Përgatitja e bilanceve vjetore, bilanceve afatgjate dhe adekuacisë, përgatitja e planeve zhvillimore dhe investive
- d) Prokurimi i energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit në tregun e energjisë elektrike
- e) Kompensimi i humbjeve në Veri të Kosovës (sipas obligimit të vendosur nga ZRRE); etj.

Ndër detyrat kryesore të aktivitetit të Operatorit të Tregut është organizimi dhe administrimi i tregtimit (shit-blerjes) të energjisë elektrike; mes tjerash edhe:

- a) Zhvillimi i Modelit të Tregut si dhe Rregullave të Tregut;
- b) Prokurimi i energjisë balancuese në koordinim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit;
- c) Organizimin e shitblerjes së energjisë balancuese dhe Llogaritja e jobalancave për palët tregtare;
- d) Menaxhimi dhe mirëmbajtja e fondit të BRE-ve sipas Rregullës për Skemën Mbështetëse
- e) Administrimi i tregut të organizuar të energjisë elektrike
- f) Mirëmbajtja e llogarive për palët tregtare
- g) Përpilimi dhe dorëzimi programeve ditore të shitblerjes te Operatori i Sistemit të Transmetimit
- h) Menaxhimi i procesit të barazimit përfundimtar financiar dhe faturimit në tregun e organizuar, alokimin e kapaciteteve, mekanizmit balancues, detyrimeve për qasje në rrjetin transmetues;
- i) Faturimi i obligimeve reciproke financiare për Operatorin e Sistemit të transmetimit dhe Operatorin e tregut dhe Palëve Tregtare
- j) Vepron si agjent për barazim financiar për Operatorin e Sistemit të transmetimit, etj

## Faturimi dhe Pagesat ndërmjet të Licencuarve

KOSTT si operator i sistemit, transmetimit dhe tregut në Kosovë bënë transmetimin e energjisë elektrike në nivele të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, dhe duke qenë monopol për transmetimin e energjisë elektrike, KOSTT sipas legjislacionit në fuqi, realizon të hyra të rregulluara nga tarifat për

Shfrytëzimin e Rrjetit të Transmetimit dhe operimin e Tregut, të cilat përcaktohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji bazuar në dokumentin Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të OST/OT.

Në përputhje me përshkrimet ligjore, OST realizon këto të hyra:

- a) të hyrat të cilat i mbledh përmes tarifave të rregulluara për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe tarifave për operatorin e tregut;
- b) të hyrat e parregulluara (të hyrat jo tarifore), të cilat i mbledh nga mekanizmi ITC (të hyrat nga tranziti i energjisë), të hyrat nga alokimi i kapaciteteve, të hyrat nga qiraja, shitja e aseteve që nuk janë në përdorim etj;

Për të analizuar se si është zhvilluar aktiviteti i blerjeve/shitjeve të energjisë për nevojat e KOSTT, ZRRE ka kërkuar të dhëna nga KOSTT në mënyrë që të nxjerr përfundimin nëse gjatë këtij procesi palët kanë respektuar kornizën ligjore dhe rregullative.

KOSTT faturon të gjithë furnizuesit për shfrytëzim të sistemit dhe tarifën e Fondit të BRE-ve, OSSH-në dhe gjeneratorët për shfrytëzim të rrjetit, për operim të sistemit dhe operim të tregut, në të njëjtën kohë pranon fatura për shërbimet e pranuar nga palët kontraktuese si KEK, OSSH, KESCO, etj.

Të dhënat lidhur me faturimin dhe pagesat mes KOSTT dhe të licencuarve KEK, KESCO dhe KEDS (deri shtator 2022) janë paraqitur në tabelën në vijim:

*Tabela 1 Faturimi dhe pagesat ndaj KOSTT*

Palët	Njësia	Borxhi i bartur 2021	Faturim	Pagesa	Borxhi Shtator 2022	Gjithsej borxhi
KEK	mil€	-1.64	11.58	11.28	-0.30	-1.94
KESCO	mil€	-39.18	54.89	50.04	-4.84	-44.02
KEDS	mil€	-12.70	14.41	23.60	9.19	-3.51
KOSTT	mil€	-0.80	5.65	3.20	-2.45	-3.25
<b>Gjithsej</b>	<b>mil€</b>	<b>-54.32</b>	<b>86.53</b>	<b>88.13</b>	<b>1.59</b>	<b>-52.73</b>

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme shihet se borxhi i akumuluar i të gjitha palëve ndaj KOSTT, në fund të vitit 2021 ka qenë në vlerë -54.32 mil€, të cilat janë bartur në vitin 2022. Bazuar në të dhënat e dërguara nga KOSTT, pjesa më e madhe e borxhit është rritur në muajin dhjetor 2021, kryesisht i shkaktuar nga jobalancet e KESCO dhe KEDS, ku KESCO vetëm në dhjetor është faturuar për jobalancë në vlerë 21.35 mil€, kurse KEDS 11.55 mil€.

KOSTT, në vitin 2022 ka faturuar palët për shërbimet e tij në total në vlerë 86.53 mil€ dhe ka pranuar pagesa në total në vlerë 88.13 mil€, duke përfunduar këtë periudhë me një bilanc prej 1.59 mil€, por kur kësaj i shtohet borxhi i bartur nga viti 2021, atëherë gjithsej borxhi i akumuluar i të gjitha palëve ndaj KOSTT arrin vlerën e borxhit në -52.73 mil€.

Nga tabela më lartë vërehet se pjesëmarrja e KESCO në këtë borxh është e lartë dhe arrin vlerë -44 mil€, ku përveç borxhit prej -39.18 mil€ të bartur nga 2021 , KESCO në këtë periudhë ka akumuluar edhe një borxh prej -4.84 mil€.

Në anën tjetër KOSTT, deri në këtë periudhë të raportimit, ka arritur të arkëtoj nga KEDS më shumë se që kishte faturuar, duke zvogëluar kështu borxhin total që KEDS kishte ndaj KOSTT nga -12 mil€ në -3.51 mil€.

KOSTT, poashtu pranon fatura nga palët KEK, KESCO, KEDS dhe tregtarët lidhur me blerjet e energjisë për mbulimin e humbjeve në transmetim dhe humbjeve në veri të vendit.

Të dhënat lidhur me faturimin dhe pagesat e KOSTT ndaj të licencuarve KEK, KESCO, KEDS dhe tregtarët (deri tetor 2022) janë paraqitur në tabelën në vijim:

*Tabela 3 Faturimi dhe pagesat e KOSTT ndaj palëve tregtare*

Palët	Njësia	Borxhi i bartur 2021	Faturim	Pagesa	Borxhi Shtator 2022	Gjithsej borxhi
KEK	mil€	-0.18	12.49	2.54	-9.95	-10.13
KESCO	mil€	0.00	1.65	-	-1.65	-1.65
KEDS	mil€	0.00	0.15	-	-0.15	-0.15
KOSTT (veri)	mil€	-14.09	45.66	46.10	0.44	-13.65
<b>Gjithsej</b>	<b>mil€</b>	<b>-14.27</b>	<b>59.95</b>	<b>48.64</b>	<b>-11.31</b>	<b>-25.58</b>

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme shihet se borxhi i akumuluar i KOSTT ndaj të gjitha palëve, në fund të vitit 2021 ka qenë në vlerë -14.27 mil€, të cilat janë bartur në vitin 2022 dhe përfshirë borxhet e akumuluar në vitin 2022 (shtator) ky borxh ka arritur vlerën -25.58 mil€.

Bazuar në të dhënat e dërguara nga KOSTT, pjesa më e madhe e borxhit është për shkak të humbjeve në veri të vendit, e cila kishte arritur vlerën -13.65 mil€, kosto të cilat nuk mbulohen përmes tarifave të rregulluara, sepse rasti është në proces gjyqësor dhe pritet shpallja e Aktgjykimit të formës së prerë, sipas Ligjit mbi Konfliktet Administrative.

#### **Të gjeturat:**

- 1. Sa i përket borxhit të akumuluar të palëve tregtare ndaj KOSTT, mund të konkludohet se KOSTT nuk ka shfrytëzuar të gjithë mekanizmat ligjor të paraparë në marrëveshjet me palët për të pamundësuar grumbullimin e borxhit të palëve ndaj tij.**
- 2. KOSTT nuk ka zbatuar garancionin bankar për palët përgjegjëse për balancim sipas Nenit 8 të Rregullave të tregut, si dhe sipas Procedurës së Rregullave të Tregut për Garancion Financiar.**

## Blerjet e energjisë nga KOSTT për mbulim të humbjeve në rrjetin e transmetimit

KOSTT, sipas legjislacionit primar të sektorit të energjisë, Neni 19 i Ligjit për Energjinë Elektrike, ndër të tjera është përgjegjës për sigurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, balancimin e sistemit dhe për shërbimet ndihmëse, sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike, transparencës dhe jo diskriminimit. Po ashtu sipas legjislacionit sekondar, parashihet që blerja e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shërbimet ndihmëse duhet të zbatohet nga KOSTT në pajtueshmëri me Procedurën për Tregtimin e Energjisë Elektrike.

Mes tjerash KOSTT lëshon urdhëresa për dispeçim të të gjitha njësive gjeneruese në përputhje me mekanizmin balancues për ndryshimin e pikës së punës brenda kufijve dinamik, si dhe ndryshimin e ngarkesës sipas mekanizmit balancues dhe mjeteve tjera të nevojshme për balancim të sistemit në përputhje me Kodin e rrjetit dhe Rregullat e tregut.

Bazuar në Marrëveshjen e Furnizimit me Shumicë (MFSH) në mes KEK dhe KEDS (KESCO), KEK është i detyruar të ofrojë sasinë e nevojshme të energjisë me prioritet tek furnizuesi (KESCO) për të furnizuar konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal dhe pjesën e mbetur të gjenerimit e ofron për OST dhe OSSH për mbulimin e humbjeve me çmime të energjisë të caktuara me marrëveshje në mes të palëve (KEK-OST dhe KEK-OSSH). Si rrjedhojë e marrëveshjes për furnizim me shumicë të energjisë elektrike të datës 17 tetor 2012, palët KEK, KEDS, KESCO dhe KOSTT bien në dakord të nënshkruajnë 'Shtojca', me afat një vjeçar, qëllimi i të cilëve është t'i bashkëngjiten dhe bëhen pjesë integrale e MFSH-së pa asnjë paragjykim për të drejtat dhe detyrimet e palëve që rrjedhin nga dispozitat e MFSH-së, dhe të pasqyrojnë çmimet që do t'i paguhen KEK-ut, të cilën KOSTT e ka përditësuar vazhdimisht, përfshirë edhe periudhën 2022-2023.

Pjesën tjetër të energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shërbimet ndihmëse, KOSTT e siguron përmes prokurimit të energjisë elektrike nga importet me tregtarë, përmes platformës për tregtim të energjisë e cila operohet dhe mirëmbahet nga Operatori i tregut. Për qëllime të monitorimit, ZRRE ka monitoruar në kohë reale procesin e tregtimit përmes platformës dhe konsideron se procesi i tregtimit është transparent, jodiskriminues dhe ofron siguri për të gjitha palët pjesëmarrëse.

Gjatë vitit 2021, KOSTT për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shërbimet ndihmëse (balancimin e sistemit) në total ka blerë energji në sasi prej 140,913 MWh, në vlerë prej 15,494,132 € me çmim mesatar prej 109.96 €/MWh.

*Tabela 4 Energjia dhe kostot për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shërbimet ndihmëse në vitin 2021*

2021		total
Sasia e kontraktuar	[MWh]	140,913
Pagesa €	[€]	15,494,132
Çmimi mesatar	€/MWh	109.96

Të dhënat lidhur me blerjet e energjisë nga KOSTT për balancimin e sistemit për vitin 2021 janë paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela 4 Energjia dhe kostot për balancim të sistemit në vitin 2021

Balancimi i sistemit 2021	Njësia	Gjithsej
Sasia e kontraktuar në ankand	[MWh]	23,112
Gjithsej	[€]	4,633,474
Çmimi mesatar	[€/MWh]	200.5

Të dhënat lidhur me blerjet e energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit për vitin 2021 që KOSTT ka realizuar me KEK dhe tregtarët tjerë janë paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela 5 Energjia dhe kostot për humbjet në rrjetin e transmetimit për vitin 2021

Humbjet në rrjetin e transmetimit 2021	Njësia	Gjithsej
Sasia e blerë nga KEK _HT	[MWh]	61,900
Gjithsej KEK për HT	[€]	2,228,400
Çmimi mesatar nga KEK	[€/MWh]	36.0
Sasia e kontraktuar Importi-HT	[MWh]	55,901
Gjithsej Import _HT	[€]	8,632,257
Çmimi mesatar Importi	[€/MWh]	154.4
<b>Gjithsej e kontraktuar</b>	<b>[MWh]</b>	<b>117,801</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>[€]</b>	<b>10,860,657</b>
<b>Çmimi mesatar</b>	<b>[€/MWh]</b>	<b>92.2</b>

Gjatë vitit 2022 (deri shtator), KOSTT për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shërbimet ndihmëse (balancimin e sistemit) në total ka blerë energji në sasi prej 78,123 MWh, në vlerë prej 9,853,728 € me çmim mesatar prej 126.13 €/MWh.

Tabela 4 Energjia dhe kostot për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe shërbimet ndihmëse në vitin 2022

2022		total
Sasia e kontraktuar	[MWh]	78,123
Pagesa €	[€]	9,853,728
Çmimi mesatar	€/MWh	126.13

Të dhënat lidhur me blerjet e energjisë nga KOSTT për balancimin e sistemit për periudhën janar-tetor 2022 janë paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela 6 Energjia dhe kostot për balancim të sistemit në vitin 2022

Balancimi i sistemit janar-shtator 2022	Njësia	Gjithsej
Sasia e kontraktuar në ankand	[MWh]	605
Pagesa për Import €	[€]	354,705
Çmimi mesatar	€/MWh	586.3



Të dhënat lidhur me blerjet e energjisë nga KOSTT për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit për periudhën janar-shtator 2022 janë paraqitur në tabelën në vijim:

*Tabela 7 Energjia dhe kostot për humbjet në rrjetin e transmetimit për vitin 2022*

Humbjet në rrjetin e transmetimit 2022	Njësia	Gjithsej
Sasia e blerë nga KEK _HT	[MWh]	51,927
Pagesa për KEK për HT	[€]	1,869,372
Çmimi mesatar nga KEK	€/MWh	36.0
Sasia e blerë nga Importi-HT	[MWh]	25,591
Pagesa për Import _HT	[€]	7,629,651
Çmimi mesatar Importi	€/MWh	298.1
<b>Total e kontraktuar</b>	<b>[MWh]</b>	<b>77,518</b>
<b>Total Pagesa</b>	<b>[€]</b>	<b>9,499,023</b>
<b>Çmimi mesatar</b>	<b>€/MWh</b>	<b>122.5</b>

Blerjet e energjisë për mbulimin e humbjeve me KEK, siç edhe është cekur më lartë, janë bërë përmes 'Shtojcës', e cila është me afat një vjeçar dhe përditësohet çdo vit nga palët dhe i bashkëngjitet marrëveshjes duke u bërë pjesë integrale e MFSH-së, derisa pjesa tjetër është siguruar përmes importit të realizuar përmes tregtarëve.

Gjatë vitit 2021, KOSTT ka tregtuar me palët tregtare si më poshtë:

- Danske Commodities Kosovo SH.P.K;
- Geni-I Tirana SHPK;
- Geni Makedonia;
- EST\_MK;
- HC Ujmani;
- Ayen Energji;
- Energia Gas;
- EDS Kosovo;
- Geni\_MN;
- Future Energy Trading; Future Energy Trading and Exchange Dynamics Sh.P.K.
- Ener Trade;
- EDS\_MK;
- GSA Kosovo.

Kurse gjatë vitit 2022, KOSTT ka tregtuar me palët tregtare:

- Danske Commodities Kosovo SH.P.K;
- Geni-I trgovanje in prodaja električne energije;
- Geni -I Prodažba na Energija DOOEL Skopje;
- Ener Trade;
- Ayen Energji;
- NOA Energy Trade Sh.p.k; -
- Interenego, energy engeering Ltd.

- INTERENERGO MACEDONIA DOOEL Skopje.
- Interenergo D.o.o. - Kosova SH.P.K.
- ETMT ENERGY SH.P.K.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, aktiviteti i furnizimit dhe tregtimit me energji elektrike mund të ushtrohen **vetëm me Licencë të lëshuar nga ZRRE për subjektet juridike që janë të regjistruara në Kosovë**, duke përfshirë edhe mundësinë që sipas **parimit të reciprocitetit** këto aktivitete të lejohen edhe pa Licencat e ZRRE-së për tregtarët të cilët kanë licenca në shtetet e tyre, e të cilat mund të njihen në Kosovë vetëm pasi të plotësohen kushtet e përcaktuara në Rregullën për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës nr 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Vlen të theksohet se kompanitë tregtare Danske Commodities Kosovo SH.P.K, Geni-I Tirana SHPK-Dega në Kosovë, EDS International Kosovo L.L.C, Future Energy Trading, GSA Kosovo, NOA ENERGY TRADE SHPK Dega në Kosovë, Interenergo D.o.o. - Kosova SH.P.K, ETMT ENERGY SH.P.K kanë licencë të lëshuar nga ZRRE, si dhe licenca e kompanisë Noa Energy Trade për aktivitet të furnizimit njihet në Kosovë sipas parimit të reciprocitetit që nga Maji 2022, ndërsa kompanitë tregtare Geni Makedonia, EST\_MK, Ayen Energji; Energia Gas, Geni\_MN, Ener Trade; EDS\_MK, Geni-I tregovnje in prodaja elektrike energjie; Geni -I Prodažba na Energija DOOEL Skopje, Ayen Energji; INTERENERGO MACEDONIA DOOEL Skopje, Holding Slovenske Elektrane (HSE), Ener Trade nuk janë të licencuar në Kosovë dhe nuk kanë licencë që i njihet në Kosovë sipas parimit të reciprocitetit.

KOSTT, në dhjetor të vitit 2020, pas nënshkrimit të marrëveshjes së kyçjes me ENTSO-E, iu është drejtuar me email të gjitha palëve tregtare që operojnë në Kosovë, duke kërkuar nga ta që të licencohen konform legjislacionit në fuqi. Megjithatë, në kuadër të monitorimit të vazhdueshëm ZRRE ka vërejtur se disa ndërmarrje kanë vazhduar të tregtojnë me kompani të palicencuara nga ZRRE.

ZRRE ka analizuar të gjitha dosjet e palëve që kanë nënshkruar kontratë kornizë me KOSTT, dhe vlerëson se procesi për para-kualifikimin për aktivitetin e prokurimit të energjisë elektrike nuk është kryer sipas dispozitave ligjore në fuqi, me ç 'rast KOSTT ka nënshkruar kontrata kornizë me tregtarë të cilët nuk kanë licencë dhe /apo njohje reciproke të licencës.

Lidhur me këtë, ZRRE ka reaguar përmes e-mail-it zyrtar si dhe me shkresë zyrtare, ku ka kërkuar nga KOSTT që të veproj në pajtim me obligimet ligjore të cekura më lartë, dhe të ndaloj aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike me ndërmarrje të pa licencuara, ku pas këtij reagimi, KOSTT menjëherë ka ndërmarrë veprime duke ndaluar tregtimin me këto kompani të palicencuara.

#### **Të gjeturat:**

- 1. KOSTT, deri në prill 2022 ka nënshkruar Kontrata Kornizë dhe ka tregtuar me ndërmarrjet të cilat nuk janë të licencuara në Kosovë, respektivisht nuk i njihet licenca e lëshuar nga vendet përkatëse, sipas parimit të reciprocitetit. Bazuar në këtë të gjetur, KOSTT nuk ka vepruar në pajtueshmëri me neni 28, par.1 dhe par. 2 dhe neni 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, neni 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, neni 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, neni 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike.**

## Blerjet e energjisë nga KOSTT për mbulim të humbjeve në veri të vendit

KOSTT, sipas nenit 5 të licencës, është i obliguar të siguroj energjinë elektrike për të mbuluar humbjet që rrjedhin nga konsumi i energjisë elektrike nga konsumatorët në katër komunat në pjesën veriore të Kosovës. Duhet cekur se kostoja për furnizimin me energji elektrike të këtyre katër komunave nuk mbulohet përmes tarifave të rregulluara, dhe ky rast është në proces gjyqësor. Andaj, deri në shpalljen e Aktgjykimit të formës së prerë, sipas Ligjit mbi Konfliktet Administrative, kosto e furnizimit me energji elektrike për katër komunat e veriut të Kosovës sipas Aktvendimit të Gjykatës nuk do të vazhdojë të mbulohet përmes tarifave të konsumatorëve fundor.

Gjatë periudhës së raportimit, energjinë për mbulimin e humbjeve për veri të vendit, KOSTT e ka siguruar pjesërisht nga KEK, pjesërisht nga ankandet ditore dhe një pjesë e ka tërhequr nga sistemi interkonektiv i Evropës Kontinentale.

Gjatë vitit 2021, bazuar në raportet mujore të dërguara nga pala, KOSTT gjatë tërë vitit në vazhdimësi ka blerë energji për mbulimin e humbjeve në veri të vendit, dhe në total ka blerë energji në sasi prej 279,597 MWh, në vlerë prej 23,331,196 € me çmim mesatar prej 83.4 €/MWh.

Të dhënat lidhur me blerjet e energjisë për mbulimin e humbjeve në veri të vendit nga KEK dhe importi për vitin 2021 janë paraqitur në tabelën në vijim:

*Tabela 8 Energjia dhe kostot për humbjet në veri të vendit për vitin 2021*

2021	Njësia	Gjithsej
Sasia e blerë nga KEK_HV	[MWh]	106,331
Pagesa për KEK për HV	[€]	3,827,916
Çmimi mesatar nga KEK	€/MWh	36.0
Sasia e blerë nga Importi-HV	[MWh]	173,266
Pagesa për Import_HV	[€]	19,503,280
Çmimi mesatar Importi	€/MWh	112.6
<b>Gjithsej e kontraktuar</b>	<b>[MWh]</b>	<b>279,597</b>
<b>Gjithsej Pagesa</b>	<b>[€]</b>	<b>23,331,196</b>
<b>Çmimi mesatar</b>	<b>€/MWh</b>	<b>83.4</b>

Duhet të theksohet se bazuar në faktin se deri në shpalljen e Aktgjykimit të formës së prerë, sipas Ligjit mbi Konfliktet Administrative, kosto e furnizimit me energji elektrike për katër komunat e veriut të Kosovës sipas Aktvendimit të Gjykatës nuk do të vazhdojë të mbulohet përmes tarifave të konsumatorëve fundor, KOSTT ka paguar këtë energji duke siguruar fonde nga dividenda e cila i është lejuar me vendim të Kuvendit të Kosovës. Vlera e pagesave të kryera nga dividenda në emër të mbulimit të humbjeve në veri në vitin 2021 ka qenë 41,806,408.31 €.

Gjatë vitit 2022 deri në periudhën raportuese, bazuar në raportet mujore të dërguara nga pala, KOSTT vetëm në muajt janar, shkurt dhe gusht ka blerë energji për mbulimin e humbjeve në veri të vendit, dhe në total ka blerë energji në sasi prej 16,373 MWh, në vlerë prej 2,963.860 € me çmim mesatar prej 181.02

€/MWh. Pjesën tjetër të konsumit të energjisë për pjesën veriore të vendit, KOSTT e ka tërhequr nga sistemi interkonektiv i Evropës Kontinentale.

Të dhënat lidhur me blerjet e energjisë për mbulimin e humbjeve në veri të vendit nga KEK dhe importi për periudhën janar-shtator 2022 janë paraqitur në tabelën në vijim:

*Tabela 9 Energjia dhe kostot për humbjet në veri të vendit për vitin 2022*

2022	Njësia	Gjithsej
Sasia e blerë nga KEK_HV	[MWh]	7,038
Pagesa për KEK për HV	[€]	253,368
Çmimi mesatar nga KEK	€/MWh	36.0
Sasia e blerë nga Importi-HV	[MWh]	9,335
Pagesa për Import_HV	[€]	2,710,492
Çmimi mesatar - Importi	€/MWh	290.4
<b>Gjithsej e kontraktuar</b>	<b>[MWh]</b>	<b>16,373</b>
<b>Gjithsej Pagesa</b>	<b>[€]</b>	<b>2,963,860</b>
<b>Çmimi mesatar</b>	<b>€/MWh</b>	<b>181.0</b>

Duke pasur parasysh se konsumi total i pjesës veriore të vendit për periudhën janar-shtator 2022 i raportuar nga KOSTT është 261,015 MWh, atëherë jobalancet e KOSTT ndaj sistemi elektroenergetik vendor për këtë energji të pjesës veriore janë 244,642 MWh. Kjo sigurisht, sikurse edhe palët tjera tregtare, ka shkaktuar edhe devijime ndaj sistemit interkonektiv të Evropës Kontinentale, për të cilat KOSTT edhe ka marrë vërejtje.

Për konsumin e pjesës veriore, përfshirë blerjet nga KEK, importi dhe devijimet e sistemit, KOSTT ka pranuar fatura në vlerë prej 46,133,547 €. Sikurse edhe në vitin 2021, në pamundësi të mbulimit të kostove për konsumin e pjesës veriore të vendit përmes tarifave të konsumatorëve fundor, KOSTT ka paguar këtë energji duke siguruar fonde nga dividenda dhe subvencioni që i është lejuar me vendim të qeverisë. Vlera e pagesave të kryera nga dividenda në emër të mbulimit të humbjeve në veri ne periudhën janar-shtator 2022 ka qenë 33,508,986 € dhe borxhi i mbetur është 12,624,561 €.

#### **Të gjeturat:**

- 1. KOSTT ka blerë energji elektrike nga KEK për mbulimin e humbjeve në Veri të vendit, nën kushtet e marrëveshjes për mbulimin e humbjeve të sistemit. Blerja e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Veri nga KEK, pa procedure tenderuese, bie në kundërshtim me procedurën e tregtimit të energjisë elektrike, pasi që në procedurë përcaktohet që tregtimi i energjisë elektrike duhet t'i nënshtrohet tregut të lirë dhe konkurrues.**
- 2. KOSTT ka nënshkruar Kontrata Kornizë me ndërmarrjet të cilat nuk kanë qenë të licencuara në Kosovë, respektivisht nuk i njihet licenca e lëshuar nga vendet përkatëse, sipas parimit të reciprocitetit. Bazuar në këtë të gjetur, KOSTT nuk ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 28, par.1 dhe par. 2 dhe neni 30, par.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, neni 32, par.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike, neni 2, par. 2.1.2, 2.1.3 dhe 2.1.6 të Rregullave të Tregut, neni 8, par. 1 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike.**

## **Devijimet e sistemit në raport me rrjetin interkonektiv**

Në javën e parë të dhjetorit 2021, në nënstacionin NS Kosova A kishte avari dhe kishte shkaktuar rënien e të gjitha elementeve të cilat kanë qenë të kyçura në këtë zarrë duke përfshirë edhe ndaljen e njësisë TCA3, përderisa deri te rënia e njësisë së TCA5 ka ardhur si pasojë e luhatjeve të mëdha të shkaktuara nga lidhja e shkurtë në sistemin e zarrave. Njësitë TCA3 dhe TCA5 kanë hyrë në funksion pas 4-5 ditësh, përkatësisht në datën 10 dhe 11 dhjetor.

Në javën e dytë të dhjetorit 2021 kishte ndalje të paplanifikuar të njësive B1 dhe B2, gjë që dërgoi në mungesë të konsiderueshme të gjenerimit vendor dhe mungesë për ngrohje termike në Prishtinë. Mungesa e konsiderueshme e gjenerimit të KEK si dhe mungesa e ngrohjes qendrore në Prishtinë ndikoi në rritjen e kërkesës për energji elektrike nga importi, duke shkaktuar kështu devijime serioze ndaj sistemi të interkoneksionit.

KEK-u ka rikthyer në prodhim njësinë TCB1 menjëherë brenda 48 orëve, ndërsa njësia TCB2 mbeti në rinovim deri më 20 janar 2022. Ndalja e njësive TCB2 vështirësoi në masë të madhe mbulimin e konsumit në njërin anë, ndërsa në anën tjetër kriza globale e energjisë rezultojë në rritje enorme të çmimeve të energjisë elektrike në tregjet ndërkombëtare.

Me datë 14 dhjetor 2021, KEDS dhe KESCO, kishin drejtuar një shkresë në adresë të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke njoftuar se me rritjen e nevojës për mbulim të konsumit, si dhe me rritjet e tepërta të çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare, të cilat kishin tejkaluar 300 €/MWh në kohën e pikut, KEDS dhe KESCO janë duke importuar rreth 1.5 milion € në ditë, kur KEK gjenerimi ishte duke operuar me 2 njësi të Kosovës A dhe dy njësi të Kosovës B. Ky import mund të dyfishohet apo trefishohet sa herë që KEK nuk operon sipas këtij planifikimi. Për më tepër KEDS dhe KESCO në këtë shkresë kishin theksuar, se nëse nuk ndërmerren hapa konkretë për të ofruar zgjidhje të

nevojshme dhe të arsyeshme, KEDS dhe KESCO e kanë të pamundur sigurimin e importit duke filluar nga 23 dhjetori dhe të njëjtit do të nominojnë vetëm energjinë e cila prodhohet në vend.

Në dhjetor të vitit 2021, si rezultat mospërputhjes mes prodhimit vendor dhe importit me sasinë që konsumohet, është tërhequr energji elektrike nga sistemi i Evropës Kontinentale. Ky dallim ndërmjet kërkesës dhe ofertës nganjëherë ka qenë 40%, prandaj Qendra Koordinuese për Evropën Kontinentale në kuadër të ENTSO-E (Swiss Grid) si dhe grupi Rajonal i Evropës Kontinentale (RGCE) organi i ENTSO-E kanë kërkuar ndërprerjen e menjëhershme të devijimeve të KOSTT ndaj rrjetit evropian të interkoneksionit. Devijimet ndaj sistemit elektroenergjetik të vendit e rrjedhimisht ndaj rrjetit evropian të interkoneksionit kryesisht kanë ardhur si pasojë e nominimeve më të vogla nga KESCO dhe KEDS për mbulimin e kërkesës për furnizimin e FSHU dhe humbjeve në Rrjetin e Shpërndarjes si dhe nga vet KOSTT për mbulimin e humbjeve në veri të vendit, me ç'rast KOSTT është detyruar të mbulojë këto jobalancë të theksuara përmes rezervave automatike dhe manuale.

Për të evituar këto devijime, KOSTT-i kishte lëshuar njoftim publik për palët ku theksonte se si pasojë e mosbalancimit në mes të konsumit të energjisë elektrike në vend dhe energjisë së ofruar nga operatorët përgjegjës në treg, aktualisht po shkaktohen jo balanca të konsiderueshme në sistemin e interkoneksionit, dhe ka kërkuar nga përgjegjësit që të veprojnë sipas Nenit 11.1.9 të Rregullave të Tregut ku kërkohet që *“Palët Tregtare të ndihmojnë OST në kryerjen e obligimeve ndaj ENTSO-E për minimizimin e Devijimeve të Paqëllimshme. Palët Tregtare janë përgjegjëse të sigurojnë që injektimi dhe konsumi momental të jetë sa më afër vlerës që është nominuar tek OT nga ana e tyre”*.

Lidhur me nominimet më të vogla nga KESCO dhe KEDS për mbulimin e kërkesës për furnizimin e FSHU dhe humbjeve në Rrjetin e Shpërndarjes, bazuar në nenin 11.3.8 të Rregullave të Tregut, KOSTT në vazhdimësi ka ngritur shqetësimin, e poashtu edhe ZRRE ka reaguar përmes shkresave zyrtare të datës 29.12.2021, ku nga KEDS dhe KESCO është kërkuar që menjëherë të ndërmarrin veprimet e duhura për nominimet në përputhje me detyrimet ligjore dhe rregullatore.

Duhet theksuar se jobalancet e shkaktuara nga KESCO në muajin dhjetor 2021 kishin arritur vlerën 21.35 mil EUR, kurse jobalancet e KEDS ishin 11.55 mil EURO.

Pas shumë vërejtjeve të pranuara nga ENTSO-E dhe SWISSGRID lidhur me devijimet e vazhdueshme të KOSTT ndaj rrjetit interkonektiv, bazuar në Kodin e Rrjetit, gjegjësisht Nenin 6 të Kodit operativ KOSTT ka filluar të ndërmarrë veprimet adekuate lidhur me reduktimin manual emergjent. Bazuar në këtë KOSTT fillimisht kishte aplikuar Fazën 1 të uljes së tensionit prej 3%, duke kaluar pastaj në Fazën 2 të uljes së tensionit në 5%, dhe duke marrë parasysh se aplikimi i këtyre masave ishte i pamjaftueshëm, ka kërkuar nga OSSH që nga data 22.12.2021 të fillojë me Fazën 3 që parasheh shkyçjen e ngarkesës, të cilën masë KEDS ka vazhduar ta aplikoj deri në njoftimin e radhës së KOSTT për anulimin e saj.

KOSTT, më datë 23.12.2021 ka dërguar në ZRRE *“Njoftim lidhur me fillimin e aplikimit të reduktimit të konsumit”*, përmes të cilit ka njoftuar ZRRE-në lidhur me veprimet e ndërmarra për zvogëlimin e devijimeve ndaj sistemit interkonektiv.

Duke parë gjendjen e krijuar në sistemin elektroenergjetik pas daljes nga operimi të njësive të KEK, pastaj çmimeve të larta të importit të energjisë si dhe devijimeve të mëdha ndaj sistemit interkonektiv, në

Mbledhjen e datës 24.12.2021, Qeveria e Kosovës vendosi për masat emergjente në furnizim me energji elektrike të cilat do të vlejshëm maksimalisht 60 ditë. Masat emergjente në furnizim me energji përfshijnë:

- Vendosjen e kufizimeve në furnizim me energji për konsumatorët, dhe
- Vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë.

Pra KOSTT kishte lëshuar urdhëresa për reduktim të konsumit duke filluar nga data 22.12.2021, derisa vendosja e masave emergjente në furnizim me energji të shpallura nga Qeveria e Kosovës është bërë më datë 24.12.2021. Nga kjo rrjedh se KOSTT bazuar në nenin 6 të Kodit operativ ka filluar të ndërmarrë veprimet adekuate lidhur me reduktimin manual emergjent, derisa kodi i Balancit paragrafi 2.5.1.1. sqaron rastet kur mund të zbatohet reduktimi; *a) Kur ekzistojnë situata të tilla që e bëjnë të pamundur parandalimin e mungesës së energjisë, masat e ndërmarrja si importet, injektimet apo veprimet balancuese nuk mund të plotësojnë kërkesën totale. Nën këto rrethana do të aplikohen dispozitat e kodit të dispeçimit dhe kodit të rregullimit të ngarkesës.*

Devijimet e KOSTT ndaj sistemit interkonektiv kanë vazhduar edhe në vitin 2022, e më të theksuara ishin në gusht 2022, kryesisht të shkaktuara nga rënia e njësisë TCB2 si dhe pamundësia e KESCO dhe KEDS për të nominuar energji për nevojat e tyre dhe pjesërisht edhe nga KOSTT për humbjet në sistem dhe në veri të vendit. Gjendja e krijuar në sistemin elektroenergjetik pas daljes nga operimi të njësisë të KEK, pastaj çmimet e larta të importit të energjisë si dhe devijimet e mëdha që do të shkaktoheshin ndaj sistemit interkonektiv, ndikuan që në Mbledhjen e datës 31.07.2022, Qeveria e Kosovës të nxjerr vendim për masat e emergjencës në furnizimin e energjisë elektrike të vlefshme për periudhën prej maksimalisht 60 ditë.

Përmes shkresës së datës 12.08.2022, KEDS dhe KESCO kanë njoftuar KOSTT-in se duke filluar nga data 15.08.2022, në programin e nominimeve tek OT do të paraqesin vetëm kërkesën e cila mbulohet nga prodhimi vendor, kjo me arsyetimin se KEDS dhe KESCO nuk kanë likuiditet financiar për t'i mbuluar kostot e importit. Në po të njëjtën shkresë, KEDS dhe KESCO kanë paralajmëruar se nuk do të mbahen përgjegjës për devijimet në sistemin interkonektiv dhe/apo ndonjë pasojë tjetër materiale dhe ligjore.

Me datën 13.08.2022, KOSTT përmes shkresës nr 1596, drejtuar bordit të ZRRE-se, ka shprehur qëndrimin e tij ndaj shkresës së KESCO dhe KEDS të datës 12.08.2022, ku mes tjerash ka njoftuar Rregullatorin se KOSTT do të detyrohet të ndërmerr veprimet e veta lidhur me rrethanat e krijuara sipas shkresës së KEDS dhe KESCO.

Në përgjigje të shkresës së KEDS dhe KESCO, KOSTT ka vlerësuar se do të ketë mungesë të konsiderueshme të energjisë elektrike për mbulim të konsumit dhe në mungesë të importit të nevojshëm do të shkaktohen devijime të mëdha të Zonës Rregulluese të KOSTT ndaj sistemit interkonektiv Evropian, dhe si veprim të arsyeshëm ka parashikuar që nga data 15.08.2022 të zbatoj reduktim të ngarkesës me rotacion sipas Kodit Operativ, duke dhënë urdhër tek KEDS për reduktim të ngarkesës me rotacion në rrjetin e shpërndarjes. Nga analizimi i të dhënave të dërguara nga palët, në urdhëresat e KOSTT për ngarkesat që duhet të reduktohen është përfshirë edhe ngarkesa për humbjet në Veri, dhe pjesërisht ngarkesa për humbjet në rrjetin e transmetimit të cilat janë përgjegjësi e KOSTT.

Nga takimet e mbajtura me KOSTT si dhe nga analizimi i të dhënave të raportuara, vërehet se KOSTT nuk ka shfrytëzuar të gjithë mekanizmat e paraparë me kodin e balancës për të parandaluar shfaqjen e

mungesës së energjisë (masat e ndërmarra si importet, injektimet apo veprimet balancuese nuk mund të plotësojnë kërkesën totale), por ka kaluar direkt në mekanizmin e fundit duke urdhëruar KEDS-in që të aplikoj reduktim të ngarkesës në rrjetin e shpërndarjes.

### Shfrytëzimi i rezervave rregulluese

KOSTT, pas tenderit lidhur me ofrimin e shërbimeve për rezervën manuale për restaurim të frekuencës mFRR, ka nënshkruar kontratë me Korporatën Energjetike të Shqipërisë Sh.a. (KESH Sh.a.), ndërsa me Oparatorin e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST Sh.a.) ka nënshkruar marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të rregullimit sekondar aFRR.

Bazuar në legjislacionin vendor, rezerva aFRR aktivizohet në mënyrë automatike për të balancuar sistemin, përfshirë këtu mungesat/tepricat e energjisë për tërë ngarkesën e sistemit elektroenergjetik të vendit, kurse ajo manuale aktivizohet në rastet kur kemi rënie të njësive gjeneruese.

Sa i përket shfrytëzimit të rezervës manuale mFRR në vitin 2021 vlera totale e aktivizimit të këtij shërbimi ishte 8,429,304.49 EUR, kurse në vitin 2022 (deri në periudhën raportuese janar-shtator) vlera totale e aktivizimit të këtij shërbimi ishte 6,178,048 EUR.

KOSTT në vazhdimësi ka shfrytëzuar rezervën aFRR për balancim të sistemit dhe në vitin 2021 vlera totale e aktivizimit të këtij shërbimi ishte 8,996,013.15 EUR dhe 3,548,016.47 EUR për Kapacitet rezervë aFRR. Kurse në vitin 2022 vlera totale e aktivizimit të këtij shërbimi ishte 18,029,222 EUR.

Bazuar në analizat e ZRRE-së, duhet të ceket se aktivizimi i rezervave rregulluese është bërë për të balancuar sistemin elektroenergjetik të Kosovës, ku shkaktar i këtyre jobalanceve përveç palëve tjera ka qenë edhe konsumi për katër komunat veriore të vendit.

Duke pasur parasysh faktin se këto kosto janë të përfshira në të hyrat e lejuara maksimale të KOSTT, atëherë shfrytëzimi i tyre në mënyrë të tërthortë për devijimet e shkaktuara nga humbjet e energjisë për pjesën veriore të vendit bie në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës ku ceket se: *“deri në shpalljen e Aktgjykimit të formës së prerë, sipas Ligjit mbi Konfliktet Administrative, kosto e furnizimit me energji elektrike për katër komunat e veriut të Kosovës sipas Aktvendimit të Gjykatës nuk do të vazhdojë të mbulohet përmes tarifave të konsumatorëve fundor”.*



#### Të gjeturat:

1. Zbatimi i masës për reduktim të ngarkesës në muajin dhjetor 2021 nga ana e KOSTT është në pajtueshmëri me Vendimin e Qeverisë për shpalljen e gjendjes emergjente të datës 24.12.2021, përveç dy ditëve 22-24 dhjetor 2021, ku KOSTT ka qenë i obliguar të zbatoj të gjithë mekanizmat sipas nenit 2.5.1.1 të Kodit të balancit (masat e ndërmarrja si importet, injektimet apo veprimet balancuese për të plotësuar kërkesën totale).
2. Sa i përket masave për reduktim të ngarkesës të vendosura nga KOSTT në muajin gusht 2022, pas deklarimit të KEDS dhe KESCO lidhur me importin e energjisë për nevojat e tyre dhe pas shpalljes së gjendjes emergjente në furnizim me energji, ZRRE ka analizuar kodet teknike të referuara nga KOSTT lidhur me rastet kur mund të konsiderohet pamjaftueshmëria e furnizimit, dhe vlerëson se Kodi i Balancit i jep të drejt KOSTT për të reduktuar ngarkesën, vetëm pasi ti ketë shfrytëzuar të gjithë mekanizmat e paraparë në pikën 2.5.1.1 të Kodit të Balancit, duke përfshirë importet, injektimet, apo veprimet balancuese për të evituar shfaqjen e mungesës së furnizimit në sistem, apo pas nxjerrjes së vendimit për masat kufizuese të rekomanduara nga komiteti teknik, gjë që nuk kanë ndodhur as nga KOSTT e as nga ministria.
3. Shfrytëzimi i rezervës aFRR, e dedikuar për balancim të sistemit, për devijimet e shkaktuara nga humbjet e energjisë për pjesën veriore të vendit, bie në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës ku kërkohet që, *deri në shpalljen e Aktgjykimit të formës së prerë, sipas Ligjit mbi Konfliktet Administrative, kosto e furnizimit me energji elektrike për katër komunat e veriut të Kosovës sipas Aktvendimit të Gjykatës nuk do të vazhdojë të mbulohet përmes tarifave të konsumatorëve fundor.*

## Shfrytëzimi i Fondit për energjinë e ripërtrishme (FER)

Fondi për energjinë e ripërtrishme është krijuar dhe menaxhohet nga operatori i tregut në përputhje me rregullën për skemën mbështetëse. Qëllimi i fondit është të rikthejë kostot shtesë të blerjes së prodhimit të BRE-ve të pranuar në skemën mbështetëse (dallimi ndërmjet tarifave nxitëse ekzituese dhe çmimit të tregut), kostot e lejuara të jobalanceve të ndërlidhura me prodhimin nga BRE-të dhe kostot shtesë të shkaktuara nga Operatori i Tregut në menaxhimin dhe operimin e FER-it.

Financimi i Fondit për Energjinë e Ripërtërishme mundësohet përmes tarifës për energjinë e ripërtërishme, e aplikuar për të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike në Kosovë. Tarifa për Energjinë e Ripërtrishme, e cila mbulon kostot e Fondit për Energjinë e Ripërtrishme, është proporcioni i kostove totale të operimit të Fondit për energjinë e ripërtrishme ndaj konsumit të parashikuar të energjisë që do të ngarkohet nga operatori i tregut. E tërë vlera e mbledhur e të hyrave duhet të alokohet në llogarinë e fondit për energjinë e ripërtërishme dhe asnjë pjesë nga ajo shumë e mbledhur nuk mund të mbahet nga OST/OT.

Duhet të theksohet se në Raportin përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara maksimale, KOSTT deklaron se një pjesë e mjeteve nga Fondi i BRE-ve janë shpenzuar për mbulimin e humbjeve në katër komunat veriore të Kosovës. Këto të hyra nuk mund të shfrytëzohen për blerjet e energjisë për furnizim me energji elektrike të komunave veriore të Kosovës dhe nuk mund të mbulohen nga tarifat e konsumatorëve të pjesës tjetër të Kosovës, sepse një gjë e tillë është ndaluar edhe me vendim të gjykatës.

Sipas kornizës rregullative në fuqi, KOSTT është i obliguar që të mbajë llogari të ndara për menaxhimin e Fondit të BRE-ve, dhe fondi duhet të përdoret vetëm për pagesën e energjisë elektrike të prodhuar nga BRE-të brenda Skemës Mbështetëse dhe në asnjë rast, KOSTT nuk mund të përdor mjetet e Fondit për qëllime tjera të korporatës, veprime të cilat do të rrezikonin likuiditetin e Fondit.

#### **Të gjeturat:**

1. Shfrytëzimi i mjeteve nga Fondi i BRE-ve për mbulimin e humbjeve katër komunat veriore të Kosovës është në kundërshtim me Rregullën për përcaktimin e te hyrave maksimale të OST/OT, respektivisht Neni 13, paragrafi 2.
2. Shfrytëzimi i mjeteve nga Fondi i BRE-ve për mbulimin e humbjeve në katër komunat veriore të Kosovës është në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës ku kërkohet që, *deri në shpalljen e Aktgjykimit të formës së prerë, sipas Ligjit mbi Konfliktet Administrative, kosto e furnizimit me energji elektrike për katër komunat e veriut të Kosovës sipas Aktvendimit të Gjykatës nuk do të vazhdojë të mbulohet përmes tarifave të konsumatorëve fundor.*